



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 1595 Prot.

Lezhë, më 02.02. 2026

VENDIM

Nr. 7, Datë 28. 01. 2026

**PËR SHITJEN NË ANKAND PËR SKRAP TË MJETEVE TË DALA JASHTË
PËRDORIMIT**

Bazuar në ligjin nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" neni 8 pika 2 dhe neni 23, Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik i ndryshuar, Urdhrat e Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit, nr 45 datë 09.04.2003, në Urdhrin e Kryetarit të Bashkisë Nr. 546, datë 10.11.2024 "Për ngritjen e Komisionit të Vlerësimit të gjendjes teknike dhe amortizimit për mjetet e Bashkisë", në Vendimin nr. 164, datë 02.05.2025 "Për miratimin e nxjerrjes jashtë përdorimit të disa mjeteve të Bashkisë", Urdhrin nr. 641, datë 25.11.2025 "Për ngritjen e grupit të punës për ngritjen e procedurës së miratimit të shitjes me ankand të mjeteve të dala jashtë përdorimit" si dhe procesverbalet e relacionet përkatëse për këtë qëllim, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë;

Vendosi:

1. Shitjen me ankand për skrap të mjeteve të dala jashtë përdorimit me peshë të përgjithshme 47739 kg, me çmim minimal 16.033 lekë/kg, me vlerë 765399.38 lekë pa tvsh dhe 918478 lekë me tvsh.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar.

SEKRETARI

FLORIDA ÇUNAJ

KRYETARI

NDUE LULI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT LEZHË
SEKTORI JURIDIK

Nr. 117/p Prot.

Lezhë, më 09.02.2026

Nr. 1595/p, prot
Dt. 9-2-26
K.B

Lënda: Kthim përgjigje në lidhje me vendimin nr.7, datë 28.01.2026 të Këshillit të Bashkisë Lezhë

KËSHILLIT TË BASHKISË LEZHË

KRYETARIT TË BASHKISË LEZHË

Në përgjigje të shkresës suaj me nr.1600 prot, datë 02.02.2026 “Dërgim vendimesh të Këshillit të Bashkisë Lezhë“, protokolluar në institucionin e Prefektit të Qarkut Lezhë me nr.117 prot, datë 03.02.2026, bazuar në nenet 8 dhe 16 të ligjit nr.107/2016“ Për prefektin e qarkut“ të ndryshuar, pasi shqyrtuam ligjshmërinë e vendimit nr.7, datë 28.01.2026 të Këshillit të Bashkisë Lezhë “Për shitjen në ankand për skrap të mjeteve të dala jashtë përdorimit“ si dhe dokumentacionin bashkëngjitur këtij vendimi shprehemi si më poshtë:

Ky vendim në bazë të nenit 3 pika 2 të ligjit nr 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë“ nuk është akt me karakter normativ.

Vendimi nr.7, datë 28.01.2026 i Këshillit të Bashkisë Lezhë është akt administrativ individual pasi i drejtohet subjekteve të përcaktuar individualisht (subjektit që shet dhe subjektit fitues të ankandit), krijon një marrëdhënie juridike konkrete dhe ka një pasojë konkrete si dhe është i shteruar në zbatimin e tij.(marrëdhënia juridike ndërmjet subjekteve kontraktuese përfundon me dorezimin e mjeteve për skrap). Ky vendim nuk plotëson asnjë kriter ligjor për t'u klasifikuar si akt normativ.

Në bazë të nenit 8 të ligjit nr. 107/2016“Për prefektin e qarkut“të ndryshuar a) Në ushtrim të funksionit të tij, prefekti i qarkut ka këto përgjegjësi kryesore:

-verifikimin e ligjshmërisë së akteve me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore;

Referuar nenit 4 të ligjit nr.107/2016 -: Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1.“Akte me karakter normativ” janë vendimet, urdhrat dhe urdhëresat e organeve të vetëqeverisjes vendore, përmes së cilave shprehet vullneti i këtyre organeve në ushtrimin e funksionit të tyre publik, që u drejtohen subjekteve të papërcaktuara të së drejtës, me qëllim përcaktimin e normave të përgjithshme të sjelljes dhe që i shtrijnë efektet në mënyrë të vazhdueshme dhe jo të njëhershme brenda territorit të juridiksionit të organit të vetëqeverisjes vendore.

Për sa më sipër verifikimi ligjor i vendimit nr.7, datë 28.01.2026 të Këshillit të Bashkisë Lezhë “Për shitjen në ankand për skrap të mjeteve të dala jashtë përdorimit“, nuk është në kompetencën e Prefektit të Qarkut.

Vendimi nr.7, datë 28.01.2026 i Këshillit të Bashkisë Lezhë “Për shitjen në ankand për skrap të mjeteve të dala jashtë përdorimit“ si akt adiministrativ individual nuk i nënshtrohet verifikimit ligjor nga ana e prefektit por hyn në fuqi sipas percaktimeve të nenit 55 pika 6 të ligjit nr. 139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore “ .

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

P R E F E K T I

Taulant MALSHI

